



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

|   |                               |                               |                               |
|---|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar<br>Priljeno/Prodato<br>Received/Delivery | 20 . 10 2023                  | 3                             | viti<br>god<br>year           |
| Organ /Njesia<br>Organ /Jednica<br>Org./Unit                | Nr Prot<br>Br Prot<br>Prot No | Shtojca<br>Prilog<br>Appendix | Sasia<br>Kolicina<br>Quantity |
| SKOPS/PAK   | 6630/2023                     |                               | 115                           |



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1113/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Arditë Haxhnikaj-Demi-anëtarë dhe Kaltrina Avdullahi-Prenaj Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1113/2023 të datës 24.08.2023, të parashtruar nga ankuesi me adresë:

kundër organit të punësimit Administrata Tatimore e Kosovës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 20.10.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1113/2023 e datës 24.08.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër Nr.12-06-3207 i datës 22.08.2023 i Divizionit të Standardeve Profesionale në Administratën Tatimore të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar sipas Akt Emërimit me numër AE.Nr.469/2022 të datës 31.12.2022 në pozitën e punës “*Inspektor i mesëm tatimor*” në Administratën Tatimore të Kosovës. Më datë 05.06.2023 ka parashtruar kërkesë me numër të protokollit Nr. ZQ/12-06/2261 në Drejtorin e Standardeve Profesionale me të cilën kërkon leje për punë sekondare jashtë Administratës Tatimore të Kosovës.

Më datë 07.06.2023 Divizioni i Standardeve Profesionale në Administratën Tatimore të Kosovës ka nxjerrë Vendimin me numër Nr.12-06-2276 me të cilin e ka refuzuar kërkesën me numër të protokollit Nr. ZQ/12-06/2261 të parashtruar nga ankuesit, për angazhim në punë sekondare në pozitën e "kameramanit, fotografit dhe ndihmësit në punët tjera" te subjekti "Binakët Pro-SHPK".

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër Nr.12-06-2276 të datës 07.06.2023 të Divizionit të Standardeve Profesionale në Administratën Tatimore të Kosovës, më datë 16.06.2023 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 4817/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se i lejohet puna sekondare jashtë orarit zyrtar si inspektor i mesëm tatimor.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datë 28.07.2023 ka nxjerrë Vendimin me numër A.nr.862/2023, me të cilin e ka obliguar Divizionin e Standardeve të Administratës Tatimore të Kosovës, që të bëjë Rishqyrtimin e lëndës për ankuesin

Divizioni i Standardeve në Administratën Tatimore të Kosovës, pas pranimit të Vendimit me numër A.nr.862/2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 22.08.2023 ka nxjerrë Vendim me numër Nr.12-06-3207 përmes të cilit i ka refuzuar kërkesën e ankuesit për angazhimin e tij në punë sekondare.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër Nr.12-06-3207 të datës 22.08.2023 të Divizionit të Standardeve në Administratën Tatimore të Kosovës, më datë 24.08.2023 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 5801/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 26.09.2023 ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesë te Administrata Tatimore e Kosovës. Ndërsa Këshilli me po të njëjtën datë ka pranuar përgjigjen në nga Administrata Tatimore e Kosovës.

Me Vendimin me numër të protokollit 6457/2023 të datës 09.10.2023, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka vazhduar afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.1113/2023 të datës 24.08.2023 edhe dhjetë (10) ditë pune.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka Administruar këto Prova:** Ankesa me numër protokollit 5801/2023 e datës 24.08.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër Nr.12-06-3207 i datës 22.08.2023; Dosja e punës jashtë orarit e datës 07.06.2023; Autorizim i Përgjithshëm mbi Ushtrimin e Aktiviteteve Zyrtare i datës 07.06.2023; Dosja e Punës Jashtë Orarit e datës 01.07.2023; Autorizim i datës 01.07.2023; Dosja e Punës Jashtë Orarit e datës 06.07.2023; Autorizim i datës 06.07.2023; Dosje për Punë Jashtë Orarit 11.07.2023; Dosja e Punës Jashtë

Orarit të Punës e datës 05.08.2023; Autorizim i datës 04.08.2023; Dosja e Punës Jashtë Orarit e datës 15.08.2023; Autorizim i datës 15.08.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 26.09.2023; Përgjigje në ankesë e datës 26.09.2023; Ankesa me numër protokolli 4817/2023 e parashtruar nga ankuesi më datë 16.06.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë për punë sekondare-jashtë ATK-së me numër Nr.12.06.2261 e datës 05.06.2023; Vendimin me numër Nr.12-06-2276 të datës 07.06.2023; Certifikatë e regjistrimit të biznesit me numër 812020311 e datës 03.03.2023; Aplikacion 25010209773 i datës 27.02.2023; Dokument identifikues për Autorizim; Dokument identifikimi për E-mail i datës 02.06.2023; Vendim për ndryshim statusi i datës 22.05.2023; Statuti i biznesit SH.P.K i datës 22.05.2023; E-mail 19.05.2023; E-mail i datës 12.05.2023; E-mail i datës 09.06.2023; E-mail i datës 07.06.2023; Akt Emërimit me numër Nr.02/1172/11 bi datës 28.08.2019; Akt Emërimit me numër Nr.02/1172/11 i datës 16.09.2020; Akt Emërimit me numër Nr.469/2022 i datës 31.12.2022; Vendim me numër 2425/01 i datës 22.12.2022; Formulari i përshkrimit të detyrave të punës; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 22.06.2023; Përgjigje në ankesë e datës 30.06.2023; Kodi i Etikës së Komunikimit në Administratën Tatimore të Kosovës me numër protokolli 09-06-1105 i datës 16.03.2023; Rregullore e Brendshme për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Administratën Tatimore të Kosovës; Formulari i deklaratës mbi gjendjen e konfliktit të interesit; E-mail i datës 15.05.2023; E-mail i datës 17.05.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar dhe ka analizuar të gjitha provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës konstaton se ankesa e ankuesit është e pabazuar, *sepse:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës, gjegjësisht Aktit të Emërimit të ankuesit me numër AE. Nr. 469/2022 të datës 31.12.2022, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se i njëjti e ushtron pozitën e punës "*Inspektor i mesëm tatimor*" në Administratën Tatimore të Kosovës, ndërsa më datën 05.06.2023 ka parashtruar kërkesë me numër protokolli Nr.prot.12.06-2261 në Drejtorin e Standardeve Profesionale të Administratës Tatimore të Kosovës përmes së cilës kërkon që ti lejohet puna sekondare si "*kameraman, fotograf dhe ndihmës në punët tjera*" për periudhën kohore nga data 01.07.2023 me afat të pa caktuar kohor në Biznesin "*Binakët Pro*" SH.P.K me numër të regjistrimit 812020311.

Divizioni i Standardeve në zbatim të Vendimit me numër A.nr.826/2023 të datës 28.07.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka rishqyrtuar edhe njëherë lëndën e ankuesit dhe më datë 22.08.2023 ka nxjerrë Vendim me numër Nr.12-06-3207 përmes së cilit e ka refuzuar përsëri kërkesën e ankuesit, me arsyetimin se pozita e Inspektorit Tatimor ka natyrë specifike të punës dhe në Administratën Tatimore të Kosovës janë përcaktuar kufizime të veprimtarive jashtë ATK-së si masa për mbrojtje të integritetit, te cilat kufizime mbështeten edhe ne nenin 11 të Ligjit Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcioneve Publike andaj angazhimi në punë sekondare në pozitën e "*Kameramanit, Fotografit dhe Ndihmësit në Punët tjera,*" në një biznes privat në lëmin e implementimeve të aktiviteteve të tatimpaguesit, që organizojnë dasma e ahengje me pozitën e Inspektorit Tatimor të cilën e mbanë ankuesi është e papajtueshme sepse nga kjo mund të dëmtohet reputacioni i Administratës Tatimore të Kosovës dhe mund të paraqet rrezik për

konkurrencën e lirë. Po ashtu Divizioni i Standardeve në këtë Vendim refuzues thekson edhe mungesën e inspektorëve tatimor dhe angazhimet e tyre jashtë orarit të punës në subjektet e gastronomisë, (subjektet që organizojnë mbledhjet muzikore, dasma, ahengje etj).

Kolegji i Këshillit lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenin 25 paragrafi 2 dhe 3 ku përcaktohet se „2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës. 3. Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike” si dhe neni 29 i këtij ligji që përcakton detyrimin për deklarimin dhe shmangien e konfliktit të interesit ku theksohet qartë se „1. Zyrtari publik ka detyrimin të shmangë çdo konflikt ndërmjet interesit të tij privat dhe interesit publik në ushtrimin e detyrës në pajtim me ligjin. 2. Zyrtari publik ka detyrimin të informojë pa vonesë mbikëqyrësin e tij, në rast dyshimi për një konflikt interesi dhe të zbatojë urdhrat e institucionit për parandalimin e konfliktit të interesit. 3. Zyrtari publik ka detyrimin të informojë paraprakisht mbikëqyrësin e tij dhe njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore për çdo veprimtari me pagesë, që kryen jashtë detyrës së tij vetëm në pajtim me ligjin” si dhe dispozitat e Rregullores e Brendshme për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Administratën Tatimore të Kosovës përkatësisht nenin 6 paragrafi 1 ku përcaktohet se: 1. “Zyrtari i ATK mund të angazhohet në punë sekondare në lëmit si: shkencë, sport, mësimdhënie, trajnime, seminare, hulumtime borde (Ndërmarrje Publike, Ndërmarrje Shoqërore dhe Organizata Buxhetore) kulturore dhe veprimtari humanitare. Këto aktivitete mund të ushtrohen nga zyrtari i ATK, nëse nuk ka konflikt të interesit apo nëse aktiviteti nuk është i ndaluar me dispozitat tjera ligjore”, dhe nenin 7 paragrafin 6 nën paragrafin 6.2 dhe 6.3 ku përcaktohet qartë se: 6.2. Zyra e Standardeve Profesionale refuzon kërkesën për angazhim në punë sekondare, në rastet kur: “6.2. Angazhimi në punë sekondare bie ndesh me legjislacionin për konfliktin e interesit; 6.3. Angazhimi në punë sekondare pengon aktivitetin në ATK”, po ashtu ka analizuar edhe Ligjin Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publikë nenin 11 ku përcaktohet qartë se: 1. Zyrtarit i ndalohet që të kryejë punë të tjera nëse: “1.1. mund të keqpërdorë informacionin zyrtar për interesa private; 1.2. punët e tilla mund të ndikojnë në paanshmërinë e ushtrimit të detyrës publike dhe cenojnë respektimin e parimeve të konkurrencës së lirë; 1.3. angazhime të tilla mund të dëmtojnë reputacionin e institucionit; 1.4. angazhimi ka të bëjë me zgjedhjen, emërimin apo caktimin në institucione vartëse të institucionit punëdhënës, me përjashtim kur një angazhim i tillë është paraparë me ligj të veçantë”, andaj marrë parasysh përcaktimin ligjor si më sipër, Kolegji konstaton se marrëdhënia e punës në shërbimin civil është marrëdhënie primare dhe se nëpunësi civil mund të angazhohet në veprimtari/punë sekondare/punë jashtë shërbimit civil vetëm në rast se ky angazhim nuk sjell rrethana të konfliktit të interesit në raport me ushtrimin e punës në shërbimin civil dhe nuk pengon kryerjen e detyrës së tij zyrtare apo realizimin e objektivave të institucionit.

Prandaj, Kolegji i Këshillit mbi këtë bazë dhe po ashtu bazuar në dëshmitë e ofruara ka konstatuar se Divizioni i Standardeve Profesionale në Administratën Tatimore të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër Nr. 12-06-3207 të datës 22.08.2023 me të cilin e ka refuzuar kërkesën për lejimin e punës sekondare të ankuesit ka vepruar në pajtim me

dispozitat e lartë cekura sepse pozita e "Inspektorit të mesëm tatimor" të cilën e mban ankuesi në Administratën Tatimore të Kosovës dhe pozita e "kameramanit, fotografit dhe ndihmësit në punët tjera" pranë biznesit "Binakët Pro SH.P.K paraqesin konflikt interesit sepse sipas formularit të përshkrimit të detyrave të punës i njëjti (bënë vizita te tatimpaguesit, ekzaminon libra, llogaritë dhe regjistrimet e mbajtura të tatimpaguesve në lidhje me zbatimin e legjislacionit tatimor në mënyrë të saktë, të plotë dhe në kohë në lidhje me obligimet e tyre tatimore), po ashtu pozita e kameramanit, fotografit dhe ndihmësit në punët tjera nuk lejohet sipas nenit 6 të Rregullores së Brendshme për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Administratën Tatimore të Kosovës, ku sipas deklarime të zyrtareve të ATK-së dhe arsytimit në Vendimin e atakuar kjo rregullore është hartuar me përfshirjen e zyrtareve kompetentë nga Agjencia për Parandalim të Korrupsionit dhe është në harmoni me Ligjin Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcioneve Publik, andaj Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit të të gjitha provave dhe fakteve të bashkëngjitura ne shkresat e lëndës ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit është i pabazuar.

Duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër Vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se Vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.1113/2023**

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Njësisë së Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMShCK- së.